

VENDIM
Nr. 783, datë 14.11.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË FËMIJËS JURGENS CUNI, AKSIDENTUAR NGA SHPËRTHIMI I NJË GRANATE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi 3 134 880 (tre milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Jurgens Cuni, aksidentuar nga shpërthimi i një granate.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha